



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 94, datë 30.06.2025

**PËR
LICENCIMIN E FONDIT TË INVESTIMIT “CREDINS DYNAMIC” TË
ADMINISTRUAR NGA SHOQËRIA “CREDINS INVEST” SH.A. - SHOQËRI
ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, të Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores nr. 133, datë 30.09.2020 “Mbi komunikimin me investitorët”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Licencimin e fondit të investimit “Credins Dynamic” dhe miratimin e prospektit të tij, si fond me ofertë publike, me pjesëmarrje të hapur të administruar nga “Credins Invest” sh.a. - shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive.**
- 2. Ngarkohen Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**